



Procesverbal nga mbledhja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Nr. 54

Datë: 18. 10. 2017, ora: 13:30

Vendi: Selia e KQZ-së/Prishtinë

Kryesues i mbledhjes: Valdete Daka, kryetare e KQZ-së

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Betim Gjoshi, Ilir Gashi, Sami Hamiti, Adnan Rrustemi, Binak Vishaj, Stevan Veselinoviq, Eshref Vishi, Ercan Spat, Bajram Ljatifi, Ergit Qeli

SKQZ: Enis Halimi, Kryeshef i SKQZ

Miradije Mavriqi, drejtoreshë e ZRPP

Përkthyes: Vera Dula

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi

RENDI I DITËS

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të KQZ-së nr.52 /2017;

2. Aktivitetet e SKQZ-së

3. Aktivitetet e ZRPP-së

1. Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për akreditimi të vëzhguesve, grupi i shtatë (VII)

2. Shqyrtim dhe miratimi i Rekomandimit për anulim të akreditim të vëzhguesve

4. Raport i Këshillave;

- **Këshilli për Operacione Zgjedhore**

- *Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesave për zëvendësime te KVV-ve sipas komunave përkatëse;*
- *Shqyrtimi dhe miratimi i draft-planit operacional për Ditën e zgjedhjeve të 22 tetorit 2017.*
- *Shqyrtimi dhe miratimi i platformës Ushahidi – Udhëzimi për raportimin e shkeljeve zgjedhore;*
- *Shqyrtimi dhe miratimi i Planit te Konferencave për Ditën e zgjedhjeve;*
- *Shqyrtimi dhe miratimi i për raportimin në mënyrë elektronike të rezultateve preliminare në Ditën e zgjedhjeve lokale të 22 tetorit 2017;*

5. *Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për zëvendësimin e ish anëtarit të KQZ-së në Këshillat e KQZ-së, z. Nenad Rikalo me anëtarin e ri të KQZ-së z. Stevan Veselinovic.*

6 .Të ndryshme

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit te KQZ-së nr.52 /2017

Valdete Daka: Përshëndetje të gjithëve, mirë se keni ardhur në mbledhjen e 54-të KQZ-së. Sa i përket rendit të ditës, a ka dikush ndonjë propozim...?

Sami Hamiti: Kryetare, ndërkohë sot kemi shqyrtuar në Këshillin për Çështje Ligjore dy zëvendësime, pra kemi edhe dy zëvendësime që vijnë nga anëtarët e kuvendeve komunale: një nga Suhareka, dhe një nga Prishtina. Ne, e kemi proceduar në këshill dhe konsideroj që është mirë të futen në rend të ditës. Po ashtu, e kemi shqyrtuar edhe një shkresë që duhet t'i drejtohet Panelit Zgjedhor lidhur me interpretimin e nenit 5.2 të Rregullores 13/2013.

Betim Gjoshi: Unë, kisha lut që kjo pikë të futet te pika 4, dhe të jetë para Këshillit për Operacione Zgjedhore, para çështjeve zgjedhore se është për nga rëndësia....! Ne si KQZ, edhe në bazë të ligjit jemi të autorizuar që të nxjerrim rregullore. Kemi parë se ditëve të fundit, kemi pasur një shqetësim të jashtëzakonshëm në publik për sa i përket disa interpretimeve në lidhje me

rregullën zgjedhore për kategoritë që ju ndalohej hyrja në fushat të cilat po ngatërrohen me tubime publike: cila është e drejtë, e lejuar me ligj që është për t'u bërë tubimi publik, e cila nuk është...!? Se do sa është e udhës të japim ndonjë interpretim si këshill për çështje ligjore, por besoj se do ta kem mbështetjen e krejt Komisionit Qendror Zgjedhor për arsye se, është devijuar nga ajo për të cilën ne edhe e kemi nxjerr këtë rregull: pra si hartues, si interpretues teknik etj.

Valdete Daka: A kemi diçka tjetër, nëse jo, kush është për me këtë rend dite me këto shtesa?

Anëtarët e KQZ miratuan rendin e ditës.

Valdete Daka: Në ndërkohë, i kisha dëshiruar mirëseardhje anëtarit të ri të KQZ-së, z. Stefan Veselinoviç dhe punë të mbarë në emër të KQZ-së.

Atëherë, pika e parë shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së KQZ-së, nr. 52. A ka dikush vërejtje? Kush është për miratimin e procesverbalit?

Anëtarët e KQZ miratuan rendin e ditës.

2. Aktivitet e Sekretariatit të KQZ-së

Enis Halimi: Sekretariati në një mënyrë po i përmbyll aktivitetet që kanë të bëjnë me implementimin e procesit zgjedhor të zgjedhjeve lokale. Ka përfunduar procesi i shtypjes votuese po ashtu si risi nga hera e fundit është se tash më flet votimet janë në depon tonë, gjithashtu është në vijim e sipër procesi i trajnimit të komisionarëve komfor planit operativ që kemi parapa për këtë aktivitet. I keni të prezantuara në faqen numër 6 dhe numër 7 tabelat në lidhje me mbarëvajtjen e trajnimit dhe procesin e monitorimit që, kemi zbatuar me këtë trajnim përfshirë edhe trajnimin e ekipeve mobile për votimin e personave me aftësi me nevojë të veçanta, trajnimin e anëtarëve të KQZ-së për procedurat e pranimit-dorëzimit, dhe trajnimin e këshillave të vendvotimit. Deri më tani, janë mbajtur 718 seanca të trajnimit me një pjesëmarrje prej 17635 të trajnuar pra. Po ashtu, do të thotë ne sikurse jeni në dijeni, në kuadër të procesit të informimit publik kemi zhvilluar disa aktivitete simuluese zgjedhore në disa universitete në nivel të republikës. Për sa i takon çështjeve që kanë të bëjnë e që lidhen ndoshta më shumë me ditën e zgjedhjeve, përkatësisht me kapacitetet tona operative në kuptim të teknologjisë informative ju njoftoj se ne kemi kontaktuar dhe bashkërenduar në aktivitetet me agjencinë e shoqërisë informative, pra institucioni përgjegjës të çështjes të kapacitetit të teknologjisë informative në nivel institucional, dhe kemi qenë në bashkëveprim të ngushtë me ta. Për sa i takon çështjeve të evitimit dhe parandalimit të ndonjë fyti të ngushtë në kuptim të rritjes së kapaciteteve për ditën e zgjedhjeve, qoftë për procesin e transmetimit të rezultateve po ashtu edhe për proceset e tjera që ndërlidhen me teknologjinë informative. Është funksionalizuar tashmë do ta shihni në mbledhjen e ardhme në këshillin e operacioneve zgjedhore, platforma për raportimin e shkeljeve zgjedhore

dhe në bashkëpunim me IFES-in dhe departamentit e operacioneve zgjedhore është lansuar moduli i trajtimit i ashtuquajtur platforma E-MSI.

Një pjesë e materialeve zgjedhore jo të ndjeshme, tha z.Halimi, janë shpërnda nëpër depot e KKZ-ve dhe në tabelën e fundit në raport e keni të prezantuar planin me të cilin ne planifikojmë që ditën e shtunë ta shpërndajmë materialin senensitiv duke përfshirë fletëvotimet dhe gjithë materialin sensitiv nga depoja qendrore në depot komunale. Deri më tani konsiderojmë që gjithçka ka shkuar përgjegjësish, sipas planifikimeve tona dhe besoj që edhe ditëve në vijim do ti kryejmë obligimet ashtu sikur kanë qenë të parapara, faleminderit.

Valdete Daka: A ka dikush pyetje për krye shefin...?

Betim Gjoshi: Më vjen mirë që këta janë bërë mësues nëpër universitete, por më shumë si anëtar, 3-4 ditë para zgjedhjeve ne jemi të interesuar që na të jemi të gatshëm që ditën e diele qytetarët e Kosovës të shprehin lirshëm vullnetin e tyre. A i kemi bërë të gjithë përgatitjet dhe, a i kemi marrë masat e duhura që qytetarët ta ushtrojnë këtë të drejtë, dhe a kemi ndonjë pengesë...?

Enis Halimi: Sfidat kanë qenë të pranishme sikurse në çdo proces zgjedhor, por me përgatitjet dhe angazhimin tonë, ne konsiderojmë që kemi arrit që t'i përmbushim këto detyrimet në kushte optimale, dhe po besojmë që heq ndonjë papara shikueshmëri besoj se, ne jemi gati për ta pritë procesin zgjedhor ashtu sikundër i kemi pritur edhe të kaluarat dhe, po besoj që trendi i rregullshmërisë dhe i mbarëvajtjes, do të shënoj rritje pozitive në këto zgjedhje.

Adnan Rrustemi: Në radhë të parë, po e theksoj këtë çështjen e ekipeve mobile për personat me nevoja të veçanta. As nuk kemi marr si informacion por, as nuk është se ka kaluar në KQZ si emërime specifike të përbërjes së tyre. Nuk e di si e keni konceptuar implementimin por, ne e dimë që përbërja e këtyre ekipeve nuk është e njëjta as në numër, e as në përbërjen e reflektimin e partive politike. Kështu që, ne duhet t'i kemi këto ekipe dhe t'i emërojmë. Tash, mbase është vonë t'i emërojmë por, së paku nuk e di a i kemi ndarë për secilën komunë ka një përgjegjësi të madhe, sidomos kur bëhet fjalë për zgjedhje lokale sepse, e dimë që në zgjedhje lokale personat me nevoja të veçanta dhe në rrethana të veçanta duhet t'i dërgohen fletë votimet e komunës përkatëse. Ata, janë në burgun e Dubravës, e që mund të jenë të komunave të ndryshme të Kosovës, duhet t'i dërgohen fletë votime të ndryshme.

Tjetra, po më intereson me ditë cili është numri i pakove të fletëvotimeve të ardhura jashtë vendit? Sepse, me datën 20, përfundon kjo periudhë. Janë disa ditë para përfundimit, dhe si informacion është i rëndësishëm. A kanë mbërritur t'i dërgojnë fletëvotimet këta pak votues të regjistruar si votues jashtë vendit...? Pastaj, a janë testuar materialet në kuptimin e cilësisë, sidomos llambat që në ditën e zgjedhjeve të mos befasohemi me ndonjë situatë kur nuk funksionojnë, ku edhe cenohet fillimi apo vazhdimi i votimit...?

Enis Halimi: Për sa i takon kësaj të fundit, pra testimi të materialeve: të gjitha materialet zgjedhore sensitive, po edhe jo sensitive janë testuar, janë pranuar në komision dhe janë testuar për cilësinë e tyre. Ajo çka vlen të theksohet, është se gjitha këto materiale janë edhe beterit edhe llambat edhe sprejit për vendosjen në gisht, janë materiale brend sepse ne kemi insistuar gjithmonë që të tilla materiale t'i kemi brend, pra që garantojnë cilësi. Dhe po ashtu, për mos t'i lënë asgjë rastit, ne kemi bërë edhe disa teste me teknologjinë që e kemi aplikuar që së paku nga viti 2013, dhe kanë dalë, kanë rezultuar të pranueshme, pra që mundën të procesohen dhe të futen në sistem. Çdo telashe ose që tenton t'i atribuohet cilësisë së këtyre materialeve, është e paqenë...Ju garantoj për këtë...!

Për sa u takon ekipeve mobile, këto i kemi marr nga rezervat pasi që edhe rezervat kanë qenë të miratuara këtu, ndërkaq sa i takon pakove të fletëvotimeve kemi marrë disa mijëra fletëvotime e që për korrektësi, nuk e kam numrin e saktë deri në këtë moment. Por me disa raunde, kemi grumbulluar fletëvotimet dhe i kemi në depon tonë, por numrin e saktë tash për tash nuk e kam...

Adnan Rrustemi: Për ekipet mobile ne e kemi emëruar, në rastin më të mirë kuotat të komisionerëve rezervë të subjekteve politike. Por përbërja e ekipeve, e thash që dallon kur bëhet fjalë për votim për persona me aftësi të veçanta. Kështu, ne duhet ta dimë kush janë përfaqësuesit ose të paktën, qysh është bërë ndarja apo përbërja e këtyre ekipeve...Këtë nuk e kemi, dhe këtë duhet me vendos këtu...! Ata janë tre anëtar dhe disa subjekte politike, kështu që ne i dimë parametrat dhe kriteret, na duhet me na e sjellë këtë material. Nuk po flasim tash për personat të cilët i angazhoni ju, normalisht që i merrni rezervat por, formula e ekipeve nuk mund t'i lihet as Sekretariatit, e aq më tepër komisioneve komunale...

Betim Gjoshi: E para është se na si KQZ, duhet me ju thonë qytetarëve të Kosovës se ne i kemi marr gjitha masat për ta pasur një proces të mirë dhe korrekt demokratik më 22 tetor. E dyta, është mirë m'i shikuar raportet dhe mësimet e zëna për zgjedhjet 2013 po 2014, dhe këto të fundit dhe, me e pa se çfarë mundet me na u paraqitur gjatë ditës së zgjedhjeve...dhe, me i marrë masa në atë drejtim. E treta, për sa i përket zarfeve të votimit jashtë vendit, i kemi në raport dhe janë rreth 2000...! Për sa u takon ekipeve me nevoja të veçanta, më kujtohet saktë se e kemi miratuar formulën, të paktën për Drenas, dhe e di saktë se e kemi miratuar dhe, rregullorja e kërkon për t'u miratuar...Kështu që, duhet ta dimë se ku mundemi t'i japim ndonjë subjekti...! Duhet me qenë transparent...

Valdete Daka: Nëse nuk kemi diçka tjetër, vazhdojmë me pikën e dytë.

3. Aktivitetet e ZRPP-së

1. Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për akreditimi të vëzhguesve, grupi i shtatë (VII)

Miradie Mavriqi: Të nderuar anëtar të KQZ-së zyra ka përgatitur rekomandimin për akreditimin e grupit të shtatë të vëzhguesve dhe gjegjësisht kanë aplikuar 22 organizata për akreditim të vëzhguesve me 824 vëzhgues. Zyra konstaton se dokumentacioni i aplikimit për akreditim të vëzhguesve është kompletuar komfor legjislacionit në fuqi dhe rekomandon akreditimin e tyre ju e keni të gjitha organizatat to të thotë një për një të listuara në vazhdim të rekomandimit. Ndërsa emrat e të gjithë vëzhguesve janë në CD do të thotë ju nuk i keni të bashkangjitura në dokumentacion, CD-t i kemi do të thotë ju do ti merrni ose menjëherë ose pas mbledhjes, ju faleminderit.

Valdete Daka: Kush është për akreditimin e këtyre vëzhguesve...?

Adnan Rrustemi: Një kërkesë për zyrën. Duke qenë që po besoj që është kontingjenti i fundit a po i vëzhguesve? Këtë dokumentin në Excel që na ke përmbledh secilën organizatë të vëzhguesve ju kisha lut që me na bo dokument të tërësishëm për cilin subjekt jo në bazë të datave që i kemi akredituar siç është tash, nuk ka nevojë grupi i parë grupi i dytë, le ta dimë finalen e numrit të asaj organizate të vëzhguesve, me e-mail mundesh me na dërguar.

2. Shqyrtim dhe miratimi i Rekomandimit për anulim të akreditimit të vëzhguesve

Miradie Mavriqi: Nëse më lejoni, në grupin e shtatë janë gjithsej, 33333 vëzhgues. Zyra, rekomandon tërheqje të akreditimit të dy vëzhguesve me kërkesën e zyrtarit të lartë komunal të Prizrenit, i cili na ka dërguar kërkesë që t'ju tërhiqet akreditimi dy vëzhguesve nga subjekti politik Lëvizja “Vetëvendosje” të cilët, janë njërit edhe komisionar... Zyra në bazë të kërkesës, rekomandon KQZ-në që të bëhet tërheqja e akreditimit të këtyre dy vëzhguesve. Emrat e tyre i keni në rekomandim.

Adnan Rrustemi: Për të qenë sqarimi më adekuat dhe i plotë, nuk është se këta kanë qenë komisionar, po në fazën e plotësimit dhe zëvendësimeve kanë kërkuar të kalojnë në vëzhgues në komisionar. Subjekti politik, e ka bërë kërkesën, natyrisht përmes konstatimit të zyrtarit komunal dhe çështja është që t'i hiqet akreditimi, se mënyra siç u prezantua i ra sikurse, ata janë emëruar në dy situata...E nuk është ashtu, thjeshtë, kanë qenë komisionar, e janë akredituar si vëzhgues. Tash, subjekti ka kërkuar m'i kaluar si komisionar...

Bink Vishaj: Desha ta pyes drejtoreshën se, ka qenë një numër prej 12 kandidatëve të cilët, kanë qenë edhe në lista garuese të partive të ndryshme edhe të cilët kanë qenë edhe vëzhgues. A i kanë dorëzuar ata ID-të, a i kanë sjell në KQZ ata ID-të? Sepse, kemi thënë që ata duhet t'i dorëzojnë ID-të që i kanë marrë, dhe janë kandidat në garë, dhe kanë qenë të pajisur me ID si vëzhgues.

Miradie Mavriqi: Zyra, menjëherë pas tërheqjes së këtyre d.m.th., akreditimit të atyre vëzhgueve, i ka njoftuar subjektet politike. Janë të njoftuara subjektet politike me sa kam njohuri, nuk kanë dërguar akoma ato ID-të. Ju kemi dhënë afat.

Valdete Daka: Atëherë kush është për rekomandimin e zyrës?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan rekomandimin e ZRPP-së

Valdete Daka: Faleminderit. Vazhdojmë me pikën tjetër. Kishim një propozim që të futet në rend dite para pikës nr. 4...Pikat për Këshillin për Çështje Ligjore....! Vazhdojmë me këtë këshill...

4. Këshilli për Çështje Ligjore

Shqyrtimi dhe miratimi i zëvendësimit të asamblastëve për Kuvendin e Suharekës dhe të Prishtinës

Sami Hamiti: Në këshillin për çështje ligjore, janë trajtuar dy zëvendësime: një nga kuvendi komunal i Suharekës, dhe një tjetër nga kuvendi komunal i Prishtinës. Që të dy janë complete, dhe sugjeroj që t'i qesim dhe t'i votojmë këto zëvendësime...

Valdete Daka: Faleminderit. Atëherë, kush është që Reshat Kabashi të emërohet anëtar i Kuvendit Komunal në Suharekë nga subjekti politik AAK-LDD, duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal, Arian Zenelaj. Kush është për?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë zëvendësim

Valdete Daka: Kush është për që Vjollca Rizani të emërohet anëtare e Kuvendit Komunal në Prishtinë nga subjekti politik LDK, duke zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal, Vlora Dumoshi. Kush është për...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë zëvendësim

Sami Hamiti: Diçka për sqarim: Nuk është çështje e biografisë, është çështje ligjore, është e përkufizuar që kuvendet komunale janë funksionale deri në konstituivin e të reja. Çka ndodh nëse prishen zgjedhjet në një komunë, ata janë të zgjedhur edhe 3-4 muaj tutje. Prandaj, është çështje ligjore, dhe duhet të kryhet. Përveç kësaj, në këshillin për çështje ligjore, e kemi trajtuar edhe çështjen e drejtimit të një shkrese shpjeguese Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në bazë të shqetësimeve që janë ngritur lidhur me sanksionimin apo dënimet që po ju bëhen partive politike. Duke u mbështetur në nenin 5. 2, është konsideruar nga anëtarët e këshillit se kjo nuk po interpretohet drejtë, sepse neni përkatës e jep që personat e caktuar në institucione shtetërore, duke përfshirë pjesën që janë deputet dhe të tjerë që zyrtar të shtetit, nuk mund të marrin pjesë aktive në fushatë. Me atë logjikë, fushata nuk do të mbahej fare, sepse në tubime

nuk do të merrte pjesë askush. Kështu që, duke u bazuar në atë që KQZ-ja është hartues dhe zbatues i rregulloreve, është dhënë një sqarim që kjo çështje të diskutohet dhe t'i jepet një shpjegim panelit zgjedhor, si trajtohet çështja e marrjes pjesë në fushatë aktive, dhe pjesës tjetër marrjes në tubime...

Valdete Daka: A ka dikush me shtuar diçka...?

Betim Gjoshi: Është e vërtetë se, ne si institucione kemi një numër të madh rregullash të cilat na ka obliguar ligji për zgjedhjet e përgjithshme dhe se ai për zgjedhje lokale që të kontribuojnë në interpretimin dhe sqarimin edhe të ligjit për zgjedhjet. Po gjithashtu, edhe në mbarëvajtjen e përgjithshme të procesit zgjedhor. Te rregulla 13/2013 ka ditë që është ngritur shqetësimi në opinion për arsye se, në bazë të nenin 5.2 të kësaj rregulle kanë filluar që të merren masa ndaj subjekteve politike dhe, është dalë nga kontesti për të cilën ne edhe e kemi rregulluar, saktësisht duke e bazuar se jemi autor edhe draftues të këtyre rregullave, miratues të tyre. Konsiderojmë se si interpretues autentik, është mirë që me sqaruar edhe opinionin po edhe instucionet e tjera që i përfshin kjo rregull. E para, liria e tubimit është e drejtë me konventa ndërkombëtare, me Kushtetutë të Kosovës dhe me ligje për tubime politike. KQZ-ja, asnjëherë nuk ka pasur qëllim që t'ju ndaloj dikujt të marr pjesë në tubime politike, e aq më pak familjarëve të kandidatëve për subjekte politike për të cilët konsideroj që vet prezantimi i familjes është një vlerë e shtuar, duke u bazuar edhe në shoqërinë dhe kulturën që ne jetojmë. Pastaj, ne nuk e kemi pasur të arsyeshme asnjëherë as nuk e kemi pasur tendencë që si KQZ ti ndalojmë pjesëmarrje, takime publike qytetarëve të kategorisë së caktuar me qenë të përfshirë në këtë rregull, as shërbyesve civil, as nëpunësve të ndërmarrjeve publike, as personave të tjerë, po as personave nën 18 vjet, dhe as shoqërisë civile, dhe askujt tjetër për të cilën është tentuar të interpretohet ky nen.

Me përfshirjen në bazë të nenin 5.2, si autor të kësaj rregullore kemi paraparë promovimin aktiv të fushatës, fjalimeve, tubimeve etj., për të cilën kemi kërkuar ti ruajmë disa institucione, disa kategori. Kjo nëse lexohet me vëmendje rregulla shihet neni 2.1 për të cilën kisha kërkuar edhe të futet në këtë shkresë thuhet, shpjegohet çka kuptohet me fushatë, fushatë kuptohet aktivisht platformave politike, ideve dhe parimeve me qëllim për të fituar vota elektorale, pra jo qëllimi pjesëmarrja pasive me dëgjuar, se gjithë qytetarët e Kosovës e kanë të drejtën për të votuar edhe e kanë të drejt me dëgjuar. Po ashtu, nuk është pse është e ndaluar që pjesëtari i FSK-së mos me marrë pjesë në tubime, ai nuk ka të drejtë me uniformë por, nuk e kemi përjashtuar dhe si të tillë, e pash njërin prej ankesave: ishte një zyrtar i ATK-së, zyrtar i thjeshtë që ka marr pjesë në tubim. Normalisht, ai është votues, ai nuk guxon gjatë punës si zyrtar i ATK-së me u përfshi në kampanjë edhe me përdor pozicionin e tyre, ashtu siç e jep edhe ligji se, nuk është e vetmja kjo rregull...Është edhe kodi etik që është si rregull 11/2013, i cili parasheh veprimet e ndaluara.

Pra, tha z. Gjoshi nuk është veprim i ndaluar që merr pjesë në tubime... Kështu që, është gabim tendenca çka kanë kuptuar me përfshi, nuk do të thotë përfshirja...Pjesëmarrja është diçka krejt

tjetër edhe kjo, ka qenë qëllimi që ne me këtë shkresë është mirë ta njoftojmë institucionin që përnjëmend, është për t'ju faleminderuar subjekteve politike se, kanë mbërritur standard, i kemi qytetet më të pastërta, sepse kanë hequr dorë prej posterve edhe mënyrave të tjera të komunikimit. Ditë e më shumë, po avancojmë duke i minimizuar shkeljet në fushat zgjedhore, dhe tash vetëm për të mbërritur në normë, dhe vetëm me e gjobitë dikën...Tash, është zbuluar kjo metodë...

Adnan Rrustemi: Është e vërtet se është bërë një interpretim sado pak të ngushtë aq edhe përtej ligjit për tubime publike edhe rregullimet publike që i bën kushtetuta, dhe në konventat për lirinë e asocimit. Megjithatë, me rregullin e kushtetutës e ka pas edhe në përmbajtje, edhe me një frymë të qartë. Çka e ndalon, është ideja se dikush ka qenë në orar të punës dhe me detyrë, dhe në mbrojtje të asaj se çka është mënyrë shtetërore nëpër fushata publike, në ndërkohë interpretimet që janë bërë kudo, edhe nëse ka qenë në cilësi të pjesëmarrjes një qytetar pa të drejtë vote, nën 18 vjet, dhe ai ka shërbyer për gjoba që ka pas prej shumë subjekte publike. E bëjë të nevojshme këtë interpretim por, kam disa sugjerime në aspektin teknik. Ne, jemi hartues të rregullave dhe, nuk jemi vetëm zbatues dhe natyrisht, dhe të figuroj vetëm hartues. Në disa aspekte krejt teknike dhe gjuhësore, është mirë për me e trajtuar edhe një herë, dhe është mirë me e pa edhe PZAP...

Betim Gjoshi: Për me e mbështetë atë se çka tha kolegu im, unë e kisha kërkuar për me e mbështetë Adnanin edhe Bajramin në hartim të shkresës...Mundësia për rishqyrtim në ligj, që d.m.th., ligji dhe ndryshimi i ligjit të nenit 116, i lejohet PZAP. Me i rishqyrtuar vendimet, ndoshta është mirë që në bazë të nenit 18.4 mundë të apelohe vendimi i PZAP, sikurse PZAP duhet ta rishikoj cilin do nga vendimet e marra. Pas prezantimit të fakteve të reja në këtë frymë, mundet edhe PZAP me e ba punën më mirë se, se e kemi edhe një raund të dytë...

Binak Vishaj: Deshta t'i mbështes kolegët për dërgimin e shkresës shpjeguese të Panelit Zgjedhor, dhe mendoj se duhet me u ri dizajnuar që kjo shkresë, veç përmbajtjes që ka si shkrim, të shihet edhe nga aspekti teknik dhe gjuhësorë. Duke u rishikuar shkresa, duhet bërë edhe interpretimi i vendimeve dënuese dhe gjobave që janë dhënë nga paneli zgjedhore...Është mirë që kjo shkresë mos të vonohet, të paktën për këto dy ditë dhe, të jemi të qartë në pjesën e raundit të dytë...Ta kenë të qartë se, ne po nxjerrin rregulla dhe, për çka nxirren rregullat...? Të përmbahemi dhe, të mundohemi t'u përmbahemi rregullave që ne i kemi nxjerrë dhe, mos të vihen gjobat sa për me b'a numër të gjobave, dhe për me i dënue subjektet politike...

Valdete Daka: Mirë, ju faleminderit në diskutime dhe, le të rregullohet kjo shkresë...

5. Raport i Këshillave

Këshilli për Operacione Zgjedhore

1. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesave për zëvendësime të KVV-ve sipas komunave përkatëse

Adnan Rrustemi: Këshilli për Operacione Zgjedhore, ka shqyrtuar në mbledhjen e fundit disa për çështjet e ndërlidhura me procesin zgjedhor, me përgatitjen e këtyre ditëve...Kërkesa e parë, ka të bëjë me miratimin e disa zëvendësimeve, transferimeve dhe plotësimeve të anëtarëve të KVV-ve për disa komuna. Dhe natyrisht, edhe një rezultat i heqjes së komisionarëve dhe emërimin e komisionarëve të ri. Ju, e keni të bashkangjitura tabelën për secilën komunë se për çfarë kategorie, sa janë larguar dhe, sa do të zëvendësohen dhe kështu me radhë...Informacionet më të detajuara janë në CD për secilën komunë. KOZ-i, e ka miratuar këtë kërkesë, dhe e rekomandon KQZ-n që t'i miratojë këto zëvendësime të nevojshme, dhe KVV-të të përfshihen në trajnim. Kështu, ne rekomandojmë që të miratohen si të këtilla...

Valdete Daka: Mirë, atëherë largohen 788, zëvendësohen 725, transferohen 409, dhe plotësohen22.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i draft-planit operacional për Ditën e zgjedhjeve të 22 tetorit 2017.

Adnan Rrustemi: Pika e 2, është draftë plani operacional për ditën e zgjedhjeve: një dokument për zgjedhjet që ne ë miratojmë...Dhe, ne si institucion duke përfshirë edhe trupat lokale në administrimin e zgjedhjeve dhe në ditën e zgjedhjeve, përfshirë edhe secilin aktivitet dhe atë në ditën e ndarjes së ekipeve monitoruse, ndarjen e roleve dhe përgjegjësinë e zyrtarëve të Sekretariatit në nivel të komisionit të zgjedhjeve, periudhën e raportimit dhomën operative të pranimit të çështjeve të ngritura, dhe urdhërimit të reagimit të shpejtë për të sanuar ose, për të parandaluar çfarë do shkelje ose parregullsi. Natyrisht, kanë ndryshuar prej zgjedhjeve të kaluara por, Këshilli i Operacioneve Zgjedhore e rekomandon KQZ-në që ta miratojë atë kërkesë të tillë, dhe natyrisht që janë dhënë disa sugjerime por, Sekretariati e ka konsideruar si të tillë të zbatueshëm...

Betim Gjoshi: E kemi pasur si ide apo me avancuar si çështje, sidomos të ekipeve në terren Na ka mbet kjo pranë vetes që ne e kemi referuar si me qenë e tillë, por unë kisha deshtë te pika 5 me kryetaren, siç edhe e kemi diskutuar si dhe pikën 8...Te pika 8: sa takim e kemi pasur, dhe është mirë me pas që të shtohet edhe një përfaqësues (5 dhe 8) kështu që, është mirë me u

shtuar...

Adnan Rrustemi: Plani i sigurisë përfshinë edhe një hierarki të komunikimit të dhomave komunale, dhe secilën palë, natyrisht që përfshin zgjedhjet dhe që dhoma informative do t'i informojë anëtarët e KQZ-së për çdo dhe orë për orë lidhur me ecurinë e procesit zgjedhorë, pastaj informacione për secilën situatë që kërkon zgjedhje dhe ndërhyrje, dhe ne rekomandojmë që të miratohet si i këtillë...

Valdete Daka: Atëherë, kush është për miratimin për këtë plotësimi...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë rekomandim të KOZ-it

3.Shqyrtimi dhe miratimi i platformës Ushahidi – Udhëzimi për raportimin e shkeljeve zgjedhore

Adnan Rrustemi: Pikë tjetër që ka shqyrtuar KOZ-i, është edhe platforma online e raportimit të zgjedhjeve. Në Kosovë, siç e dimë platforma e zgjedhjeve zgjedhore është ndërtuar në bazë të sistemit të USAID-it që, është një praktikë e tashmë ndërkombëtare, e dëshmuar për raportim të shpejt të zgjedhjeve, me qëllim të rritjes së transparencës por, edhe me qëllim të rritjes së efikasitetit të reagimit të shpejtë të institucioneve në administrim dhe në raportimin e procesit zgjedhor. Platforma dhe menaxhimi i saj, platforma e dhomës operative, e dhomës së KQZ në ditën e zgjedhjeve, nuk e zëvendësojnë atë në raport të tjerë me KQZ-në...Secila palë e përfshime në proces, mund të raportojë përmes këtyre të tri kanaleve në çfarëdo situatë, dhe kundrejt çfarëdo informacioni, dhe si rezultat i kësaj mund të reagojë sipas nevojës! Sistemi, është i dizajnuar aq mirë sa të dhënat e procesuara të vijnë shumë shpejtë... Në dispozicion të dhomës operative, KQZ-së dhe organeve të sigurisë, është përgatitur një udhëzim për raportim të këtyre zgjedhjeve që, do t'u shpërndahet komisionarëve dhe vëzhguesve për mënyrën e raportimit. Janë pyetjet që duhet të plotësohet para se të raportojnë, dhe të komunikimit që duhet të bëhet në mes të operatorëve dhe raportuesve, në këtë rast edhe për ta konfirmuar secilën çështje. Brenda materialit që e kemi të paraqitur edhe në skemën e funksionimit komplet të këtij operacioni, d.m.th, fakti se kush ka të drejtë të raportojë, si raportohet në operatorin e të dhënave, s'i të rishqyrtojmë informacionin, pastaj do të analizohet kthimi i informatës...! Vërtetimi bëhet përmes zyrtarëve komunal dhe trajnerëve, menaxherëve të Qendrave të Votimit dhe kështu me radhë, deri tek identifikimi edhe i shkeljeve...Natyrisht, edhe pas shqyrtimit vendos KQZ për secilin rast, mandej se kur do të publikohen...

Ne, e rekomandojmë KQZ –në që, në njëfarë mënyre me bërë pilotimin e projektit dhe që ta miratojë si të këtillë, dhe pastaj t'i informojmë aktoret e tjerë dhe subjektet tjera që ta kenë këtë mundësi shtesë për të raportuar mbi çfarëdo parregullsie ose shkelje në proces...

Betim Gjoshi: Fillimisht, dëshiroj që mos të ketë asnjë shkelje gjatë procesit zgjedhorë, dhe

është shumë me rëndësi që si KQZ me marrë një varg masash të cilat i shërbejnë procesit të rregullt dhe transparencës së zgjedhjeve, demokracisë në vend... Dhe një prej tyre, është edhe kjo që sot ne po e miratojmë... Besoj, edhe personat e tjerë jashtë KQZ na ndihmojnë në raste, eventualisht paraqitet ndonjë shkelje në mënyrë që ne ta mësojmë sa më shpejtë.. Pra, qëllimi në fund të fundit i kësaj është që, si KQZ të ndërmarrim masa që shkeljet të riparohen, ato shkelje që eventualisht ndodhin...Shfrytëzoj rastin ta falënderoj IFESIN si ndihmës në këtë proces, kuptohet edhe Sekretariatit. Ne, do të jemi edhe vetë si anëtar të komisionit zgjedhor në krye të procesit, dhe do ti publikojmë edhe zgjedhjet, do t'i publikojmë edhe të gjitha rastet kështu që, ne do të jemi edhe më të monitoruem...

Binak Vishaj: Është e vërtetë se, është një standard i ri që ndikon në rritjen e kualiteti në procesin e zgjedhjeve. Ky, është një lajm i mirë dhe i gëzueshëm për të gjithë por, ajo çka deshta me pyet kryesuesin është se, kush i mbikëqyrë raportet informative që vijnë prej terrenit, kush i monitoron...? A do të ketë mekanizëm të veçantë që krijohet në ditën e zgjedhjeve sikurse Dhoma Operative...? A është që e ka vetëm target, vetëm platformën, a na jep më shumë detaje në këtë fushë, në fushën e mbikëqyrjes dhe të informimit, të klasifimit të raporteve që vijnë etj.

Adnan Rrustemi: Ju, e keni raportin të përshkrum në detaje komplet funksionimit me të gjitha skemat, e evidenton në pika të trasha se si funksionon. E para, duhet ta kemi parasysh se jo çdo gjë raportohet edhe publikohet automatikisht, ka një nivel të qartësishëm të brendshëm...Ky sistem, nuk është shumë i qasshëm për publikun, por e ruan njëfarë lloj autonomiteti, dhe ka një hierarki të kronologjisë, prej personelit zgjedhor që e kanë mundësinë përmes sms-ve, thirrjeve telefonike dhe imellave për me raportuar pastaj, operatorët e të dhënve që janë të vendosur në nivel të dhomës operative të Sekretariatit. Ne, i pranojmë këto raportime dhe i analizojmë në këto dy nivele: vërtetimi i informatës sa, është e saktë dhe e miratuar - vërtetimin e bëjnë zyrtarët komunal të zgjedhjeve në komunën përkatëse ku ka ndodhë çështja dhe anëtarët e KKZ-ve me trajnerët, dhe ku bëhet fjalë për qendrën e caktuar të votimit. Pastaj, bëhet me kryesues të vendvotimeve, ku shkon deri në nivel të fletëvotimit, dhe bëhet edhe analiza e informatës se, a është zgjidhur çështja apo në cilin nivel është bërë ndërhyrja për ta sanuar informatën. Natyrisht, vetëm regjistrohen informatat që vërtetohen por ato, nuk publikohen...

Përgjegjësitë dhe dizajnesit, si dhe hartuesit e platformës edhe të dokumentit, konsideroj se kanë qenë në nivel të përgjegjshëm. Kjo, është mënyra se si funksion platforma dhe këto, janë përgjegjësitë tona në këtë mes...

Binak Vishaj: Duke ju referuar ju të KOZ-it se jeni më të informuar dhe po ashtu, jeni më të familjarizuar me temën që për neve është hera e parë që e trajtojmë, për këtë edhe deshta me ditë se cila është rruga prej marrjes së raportit dhe te publikimi: Kush e lejon, kush e klasifikon, si të trajtohet sepse këto janë me rëndësi...Kjo, po diskutohet për herë të parë dhe po aplikohet për herë të parë...

Adnan Rrustemi: Mendoj që isha i qartë, gjithçka jepet në nivel operativ! Por, ajo çka është me rëndësi lidhet me atë se kjo platformë nuk e zëvendëson mënyrën klasike, dhe raportimin klasik përmes dhomës operative. Edhe pse ne konsiderojmë se duhet ta ruajmë këtë, se mund të jenë për plotësime, dhe jo për zëvendësime, përjashtime kështu që, me konsiderojmë që të rekomandojmë KQZ-në për ta miratuar këtë platformë...

Valdete Daka: Kush është për këtë rekomandim...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë rekomandim të KOZ-it.

4. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Konferencave për Ditën e Zgjedhjeve

Adnan Rrustemi: Po i bashkoj këto dy pika që janë mjaft teknike. E para, është edhe plani i Konferencave për media të Komisioni Qendror të Zgjedhjeve. Kështu, është ruajtur tradita e zakonshme. Konferencën e parë e kemi në ora 8 për hapjen e Qendrave të Votimit në tërë vendin, pastaj në 11.30 është konferenca e dytë për Pjesëmarrjen dhe Ecurinë e Procesit të Zgjedhjeve. Në 15.30, është konferenca e tretë, e cila lidhet po ashtu për Pjesëmarrjen dhe për Ecurinë deri në ora 3. Dhe konferenca përmbyllëse, është në orën 8, ku edhe publikohen të dhënat përfundimtare për pjesëmarrjen, mbylljen e vendvotimeve dhe ecurinë e fazës së votimit. Kjo, është skema. Natyrisht, për rezultate preliminare varet nga raportimet, e deri më vonë edhe mund të kemi konferencë për media dhe publik.

Betim Gjoshi: Ndoshta, vetëm sa për opinion mendoj që është me rëndësi që me dalë sa ma shpejt me raportet zgjedhore, sepse do ta kemi edhe projektin Ki – vote. Kemi kërkuar nga dy sektorët, trajnimi dhe koordinimi në terren që kryesuesit e vendvotimeve me i informuar edhe me kërkuar menjëherë pas procedimit, të kryesuesit e komunave që ti fusin të dhënat që janë në çdo Qendër të Votimit që, me të vërtetë ne ti kemi sa ma shpejtë rezultatet. Nëse kjo funksionon, deri në orën 10 në mbrëmje mund t'i kemi rezultatet preliminare. Sa i parkete rezultatit për zgjedhjet për kryetar komune, është kërkuar edhe rritje e transparencës në fotokopjimin e formularit dhe fotografimin e tyre për Këshillat e Vendvotimit nga përfaqëuesit e Subjekteve Politike me qëllim që me e rritë transparencën...Ne, do të vazhdojmë edhe kësaj radhe me siguri me skenime dhe publikime por, po flasim që në vendvotime me ua mundësuar ankesat atyre që konsiderojnë se u janë shkelë të drejtat...

Adnan Rrustemi: Nga kjo që u tha, është e vërtetë që kemi kërkuar nga Sekretariati që po e formalizojmë në udhëzime dhënien me prioritet të informacioneve për informim të situatës preliminare që, t'i dërgohet një shkresë të KKZ-ve që secili vëzhgues ose komisionar ka të drejtë në nivel të fletëvotimit të fotoqafoj secilin formular të përputhjes së rezultateve, si dhe rezultatit e kandidatëve dhe, në anën tjetër KKZ-të të informojnë në ditën e nesërme. Kjo, nuk është paraparë në afatin e ankesave për mbarëvajtjen në Vendvotim 24 orë nga momenti i votimit...

Binak Vishaj: Unë, e pata fjalën tek plani i Konferencave...Ne, përveç rezultateve zyrtare perliminare, kemi edhe rezultatet e daljes në zgjedhje të qytetarëve përmes projektit Ki – vote...Në ora 11, e dimë se sa për qind e qytetarëve kanë dalë në zgjedhje...Mendoj se, me dalë në 11.30, është pak kohë shumë e largët. Gjithë kohën, ne e dimë se sa qytetar janë pjesëmarrje në zgjedhje, meqë e kemi aktive dhomën operative...Kërkojmë nga dhoma operative që të na bie të dhënat për shkeljet eventuale dhe ne, në ora 11-të, të dalim me rezultatet e caktuara dhe ta informojmë opinionin. Është e rëndësishme konferenca e KQZ-së...!

Valdete Daka: Gjithsesi, ndoshta mund të ketë edhe pyetje për media gjatë konferencës, atëherë është për këtë rekomandim...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan edhe këtë rekomandim të KOZ-it

6. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për zëvendësimin e ish anëtarit të KQZ-së në Këshillat e KQZ-së, z. Nenad Rikalo me anëtarin e ri të KQZ-së z. Stevan Veselinoviq

Valdete Daka: Atëherë, pika tjetër është: Zëvendësimi i ish anëtarit të KQZ-së, z. Nenad Rikalo me anëtarin e ri, z. Stefan Veselinoviq.

Enis Halimi: Kjo, është një praktikë që anëtarët e rijnë me u formalizuar në këshillat e KQZ-së.

Valdete Daka: Aty ku ka qenë ish anëtari z. Nenad, në ato këshilla do të merr pjesë anëtari i ri...

Betim Gjoshi: Ka vite që kjo praktikë, është duke u zbatuar sipas rregullores së punës! Kolegut, i uroj punë të mbar dhe, shpresoj që ka me dhënë kontribuar që ky institucioni yni me e ruajtur integritetin në procesin zgjedhorë, dhe në funksionet më të rëndësishme...Konsideroj se, sipas rregullit, është si trashëgimi që anëtari zëvendësues me u kyç në këshilla ku paraprakisht, ka qenë anëtari paraprak! Kriteret janë profesionale, dhe parashihet se kush ku është në këshilla. Ndoshta, kolegu është njoftuar se në cilat këshilla duhet me qenë, ndonëse jemi në proces zgjedhor...Para se kryetarja ta nënshkruaj vendimin, specifikojeni saktë se ku ka me qen, në cilat këshilla kolegu...

Valdete Daka: Kush është për që të zëvendësohet z. Veselinoviq deri në certifikim e rezultateve...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan kouptimin e z. Veselinoviq nëpër këshilla, deri në certifikim të rezultateve të zgjedhjeve lokale 2017.

7.Të ndryshme

Stevan Veselinoviq: Mbi të gjitha, falënderoj kryetaren dhe kolegët për fjalët përshëndetje të mirëseardhjes sime. Dëshiroj të shpreh gëzimin tim që jam tani anëtar i KQZ-së. Pajtohem me bisedat e më parme që pjesëmarrja në këshilla të bëhet mbi bazën e përgatitjeve profesionale. Unë nuk kam qenë i informuar, por pavarësisht, kjo është dita ime e parë dhe, edhe zgjedhjet janë në proces...Me profesion jam ekonomist, dhe shfrytëzoj rastin që t'ju kujtoj se, pavarësisht që kam përkrahur gjithë diskutimet në mbledhje, materialin që e kam përpara nuk e kam në gjuhën serbe dhe nuk e kuptoj...Prandaj, duke ju falënderuar shpresoj në bashkëpunim dhe mirëkuptim...

Për KQZ

Valdete Daka, kryetare
